



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 241, datë 03.08.2012

“Për

nje shtese në VKK Nr.225, datë 28.05.2012 mbi “Përfshirjen nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive në tregun e sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e “Policës Kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Servete	GRUDA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.08.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Shqyrtimin e nje shtese në VKK Nr.225, datë 28.05.2012 mbi “Përfshirjen nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin “Policë Kufitare e mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

Baza ligjore:

Nenet 24, *germa d*, dhe 51, *germa a*, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës mbi kërkesën e operatorit ANSIG sha për përfshirjen në përfshirjen nga marrëveshja e bashkëpunimit mes shoqërive që operojnë në tregun e sigurimeve,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1.Byroja Shqiptare e Sigurimeve (këtu e si vijon BSHS) bashkarisht me "ANSIG" Sh.a., me shkresën nr. 41 prot të datës 12.07.2012 (me nr.497prot. brendshëm, dat.12.07.2012), paraqiti një kërkesë për përfshirjen edhe të ndërmarrjes "ANSIG" Sh.a. me nr. NIPT-i Nr. L21319037M dhe datë të Regjistrimit 10.01.2012 në VKK Nr.225, datë 28.05.2012, i cili lidhet me "Përrjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin "Policë Kufitare e mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", (e cila në vetvete nuk është veçse një marrëveshje për bashkëpunim mes antarëve të saj).

2.Kërkesa në vetvete shoqërohej edhe me dy vendimet e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (në vijim AMF-së) përkatësisht VAMF Nr.155, dat.23.11.2011 "Mbi miratimin paraprak të shoqërisë ANSIG Sh.a. për ushtrim veprimtarie në sigurime për klasat e jo-jetës"; VAMF Nr.76, dat.22.06.2012 "Për miratimin e dhënies së licencës për ushtrim veprimtarie sigurimi për klasat e jo-jetës". Njëkohësisht konfirmohej se me Vendimin e Asamblesë së Shoqërive të Sigurimit të datës 09.07.2012 ishte pranuar aderimi i ndërmarrjes "ANSIG" Sh.a. në marrëveshjen e tyre të bashkëpunimit të përjashtuar nga VKK Nr.225, objekt-ndryshimi.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); dhe 51, (germa a); të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

V E N D O S I:

1. Në pjesën konstatuese (vërejtëse) të VKK Nr.225, datë 28.05.2012 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në pikën I "Procedura e ndjekur", pas emrit të ndërmarrjes "ALBSIG" Sh.a. shtohet edhe shprehja **"ANSIG" Sh.a.**
 - b) Në pikën II "Palët në marrëveshje", në paragrafin e dytë të saj pas "ATLANTIK" Sh.a. shtohet edhe shprehja: **"Shoqëria e Sigurimeve 'ANSIG' Sh.a."**
2. Ndërsa pika 1 e dispozitivit të këtij vendimi Nr.225, datë 28.05.2012 ndryshohet sa vijon:

-"Të përjashtojë individualisht nga ndalimi ne marrëveshjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit për ofrimin e shërbimit të Policës Kufitare të Sigurimit të Detyrueshëm të mjeteve motorrike për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta, midis shoqërive të sigurimit: "INSIG" Sh.a, "SIGMA VIG" Sh.a, "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" Sh.a,

*“INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTIK” Sh.a,
“EUROSIG” Sh.a, “ALBSIG” Sh.a. dhe “ANSIG” Sh.a.”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Iva Zajmi

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR